



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 22, datë 30.3.2017

**Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme,
të shkaktuara nga zjarri dhe fatkeqësi natyrore**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/ shkronja "ë" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017",

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Halit Shpuza**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Mehmet Shpuza**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 3 (tre) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **60,000** (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
3. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **znj. Qamile Muhari**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e saj përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.

4. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **znj. Shuke Rama**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (dëbora e ngrica). Familja e saj përbëhet prej 1 (një) anëtar dhe ndihma financiare të jetë në shumën **20,000** (njëzet mijë) lekë.
5. Burimi i financimit të jetë fondi i drejtorisë së emergjencave civile dhe MZSH-së, parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017 të miratuar me VKB nr 8, datë 30.1.2017, në programin P13, F1 O2 A1.
6. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës 160,000 lekë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.3.2017

Shpallur në datën 30.3.2017


Sekretar i këshillit



Suel Hadri



KRYETAR



Xhemal BUSHATI